

URDHËR
Nr. 399, datë 1.8.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 4.8.2014 deri në datën 20.8.2014, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Ildir Peçi dhe nga data 20.8.2014 deri në datën 30.8.2014, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Arben Isaraj, brenda fushës së kompetencave të deleguara me urdhrin nr. 7, datë 8.1.2014, të ministrit të Drejtësisë.
2. Ngarkohen zëvendësministrat e Drejtësisë z. Ildir Peçi dhe z.Arben Isaraj për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço